



Pranuar / Dorezuar Priljena / Prodato Received / Deliverty	23. 09 2022	2	viti god year
Organ /Njësia Org /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKPM/STACK	5639/2022		116



## Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.696/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetare, Arben Mehmeti- dhe Ardita Haxhnikaj-Demi, anëtarë si dhe Zyle Millaku Gojnovci - Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, kanë shqyrtuar ankesën me numër A.nr.696/2022 të datës 10.08.2022, të parashtruar nga ankuesi me adresë banimi në Komunë të Vushtrrisë, në çështjen juridike "kontestim konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 22.09.2022, mori këtë:

### V E N D I M

- I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.696/2022 e datës 10.08.2022 e parashtruar nga ankuesi
- II. Anullohet Vendimi Nr.78/2022 me numër protokolli 03-154/3 i datës 18.07.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë.
- III. Obligohet Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, që të bëjë zbatimin e këtij vendimi brenda afatit prej 15 ditës nga dita e pranimit të tij dhe të ndërmarr veprimet për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë.
- IV. Obligohet Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, pas ndërmarrjes së veprimeve si në pikën III të këtij vendimi të zhvilloj procedurën e lëvizjes brenda kategorisë sipas konkursit me nr. reference RN00008455 për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike", në pajtim me legjislacionin në fuqi.

V. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duhet të njoftohet me shkrim lidhur me veprimet e ndërmarra për zbatimin e këtij vendim

### A r s y e t i m

Ankuesi [ ] i punësuar në Ministrinë e Drejtësisë sipas Akt emërimit të datës 08.08.2012 në pozitën "Shef i Sektorit të Transportit dhe Hapësirave të Punës", ka aplikuar në konkursin e shpallur nga Ministria e Drejtësisë për lëvizje brenda kategorisë në pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike", sipas njoftimit të datës 07.03.2022 për aplikim nga data 22.03.2022 deri me datë 30.03.2022.

Në këtë konkurs në bazë të listës së aplikacioneve kanë aplikuar dy kandidatë, ndërsa me datë 06.04.2022 ankuesi është njoftuar nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore të Ministrisë e Drejtësisë, se i ka plotësuar kushtet për lëvizje brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike", dhe është përfshirë në listën e kandidatëve të aprovuar me numër të kodi RAN0003594, kurse kandidatit tjetër më datë 06.04.2022 i është refuzuar aplikacioni në fazën e verifikimit paraprak.

Kandidati të cilit i është refuzuar aplikacioni më datë 12.04.2022 ka parashtruar ankesë tek Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, ndërsa të njëjtit i është refuzuar ankesa sipas Vendimin me numër DBNJ-Nr.03/2022 të datës 19.04.2022 të nxjerrë nga Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, po ashtu kundër këtij vendimi ky kandidat me datë 06.05.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes Vendimit Anr.443/2022 të datës 15.06.2022 ka refuzuar ankesën e ankuesit duke e lënë në fuqi Vendimin me numër DBNJ-Nr.03/2022 të datës 19.04.2022 të Njësies së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Drejtësisë.

Më pas me datë 18.07.2022 Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, ka nxjerr Vendim Nr.78/2022 me numër protokollit 03-154/3, me të cilin e ka anuluar konkursin për lëvizje brenda kategorisë, më arsyetimin që procedura nuk ka përfunduar brenda 45 ditësh. Ankuesi [ ] me datë 19.07.2022 përmes E-mailit zyrtar është njoftuar nga Zyrtari i Personelit i Ministrisë së Drejtësisë, se është anuluar konkursi i shpallur nga Ministria e Drejtësisë për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike".

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin Nr.78/2022 e datës 18.07.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë për anulimin e konkursit për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike", më datë 10.08.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendime ankimore se procedura e rekrutimit për lëvizje brenda kategorisë është shpallur konform ligjit në fuqi kurse anulimi i tij është i pa bazuar dhe i pa arsyetuar.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 22.08.2022 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesën e ankuesit tek Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë. Këshilli me datë 26.08.2022 me numër protokoll 4989/2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e lëndës, e cila është plotësuar me prova shtesë, për mes E-mailit zyrtar të datës 26.08.2022 nga arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar KPMSHCK-së.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova:** Ankesën me Nr.Prot:4327/2022 të datës 10.08.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datë 9.07.2022 Njoftim nga Zyrtari i Personelit në Ministrinë e Drejtësisë, lidhur me Vendimin e datë 18.07.2022 të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; E-mail i datës 20.06.2022 për shtyrje të intervistës nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë; Vendimin e datës 18.07.2022 Nr.78/2022 me numër protokoll 03-154/3 i Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë; Konkursi i shpalljes sipas njoftimit të datës 07.03.2022; Fletë dëshmi e datës 22.07.1999 me nr. 125/99; Përgjigje në ankesë me datë 26.08.2022 me numër protokoll 4989/2022 nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, dhe provat shtesë për mes E-mailit zyrtar të datës 26.08.2022 nga arkivi i Ministrisë së Drejtësisë, drejtuar KPMSHCK-së; Vendim nr. 33/2021 i datës 18.05.2021 me numër protokoll 02-514; Akt emërim i datës 08.08.2012 i ankuesit; shkresë nga procedura e rekrutimit me zgjedhjen e ankuesit në pozitë: "Shef i Sektorit të Transportit dhe Hapësirave të Punës"; Aplikacioni i ankuesit; certifikatë dhe reference e punës e datës 08.08.2009 lëshuar nga HQ-KFOR; certifikatë e datë 2.06.2021 lëshuar nga IKAP; certifikatë e datës 09.11.2017 lëshuar nga CMEP; certifikatë e marrëdhënies së punës e datës 10.10.2007; lëshuar nga Ministria e Drejtësisë; Diplomë Universitare me nr. 152/10 e datës 01.11.2010 lëshuar nga Kolegji Universitar Tempulli, e vërtetuar me datë 05.01.2011 nga MASHT; Diplomë e Masterit datë 04.02.2015 me numër MP-59 me nr.amze 80 lëshuar nga Universiteti Politeknik i Tiranës; Referencë e datë 05.12.2005 lëshuar nga UNMIK; Vërtetim i datës 25.03.2005 lëshuar nga në Vushtri; Vërtetim i datës 24.03.2022 lëshuar nga Ministria e Drejtësisë; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës e datës 21.01.2021; Formulari i vlerësimit të rezultateve në punës e datës 06.01.2022; Pasqyra tabela e nxjerrë nga sistemi SIBMNJ-së nga konfirmimi i aplikacionit deri tek verifikimi paraprak; Njoftimi i datës 19.07.2022 për mes E-mailit nga Zyrtari i NBNJ-së, për anulimin e procedurës së pranimit për lëvizje brenda kategorisë; Vendimi ZSP-Nr.29/22 i datës 28.02.2022 me numër protokoll 03-154/2; Vendimin Anr.443/2022 e protokolluar me numër 3513/2022 i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail i datës 21.06.2022, nga Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, për propozim të Vendimin për themelimin e Komisionit KVLBK-së drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, të bashkangjitur formën e Vendimit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, duke shqyrtuar të gjitha provat e lëndës, konstaton se ankesa e ankuesit është e bazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit kundër anulimit të konkursit për lëvizje brenda kategorisë, ka konstatuar se në bazë të provave të lëndës, procedura e lëvizjes brenda kategorisë për pozitën Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informative dhe Shërbime Logjistike, është pezulluar dhe nuk është vazhduar nga faza e verifikimit paraprak për faktin që njëri nga kandidatët ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, sepse pezullimi ka efekt sipas nenit 130 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *“1. Përveçse kur parashikohet ndryshe me ligj, parashtrimi i një ankese pezullon, sipas fuqisë së ligjit, prodhimin e pasojave juridike të aktit administrativ, deri në njoftimin e vendimit që zgjidh ankesën 2. Nëse në aktin administrativ përfshihen dy ose më shumë palë me interesa të njëjta, ankesa e paraqitur nga njëra nga palët, pezullon prodhimin e pasojave juridike të aktit ndaj të gjitha palëve të përfshira”*, ndërsa pas Vendimit me numër A.nr.443/2022 të datës 15.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës përmes të cilit është refuzuar ankesa e palës në rastin konkret ankesa e ankuesit Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë më datë 21.06.2022 e ka njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, lidhur me pranimin e Vendimit me numër A.nr.443/2022 të datës 15.06.2022 të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Bazuar në provat e lëndës dhe duke u bazuar në kompetencat e përcaktuara me nenin 46 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, Udhëheqësja e Divizionit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë më datë 21.06.2022 ka njoftuar Zëvendësuesin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë se kanë përgatitur propozimin e vendimit për themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë, duke bashkangjitur edhe vendimin për nënshkrim, mirëpo Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë pa ndonjë arsye për gati një muaj nuk ka ndërmarr ndonjë veprim lidhur me këtë, ndërsa më datë 18.07.2022 përmes Vendimit Nr.78/2022 ka anuluar konkursin me arsyetimin që kanë kaluar afatet për përfundimin e procedurës administrative duke i'u referuar nenit 34 paragrafi 4 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, nenit 9 paragrafi 3, nenit 15 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 98 paragrafi 2 dhe nenit 130 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Lidhur me ligjshmërinë e Vendimit me numër Nr.78/2022 të datës 18.07.2022 të Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, konstaton që Sekretari i Përgjithshëm me rastin e nxjerrjes së vendimit kontestues respektivisht me arsyetimin e tij nuk ka arritur në mënyrë të drejtë të arsyetoj shkaqet e anulimit të procedurës së rekrutimit, sepse neneve të cilëve i është referuar në vendim nuk kanë të bëjë me rastin konkret sepse sipas Kolegjit, ky nen duhet të aplikohet në rastet kur procedura administrative zhvillohet pa pengesa dhe e njëjta nuk përfundon brenda 45 ditësh, ndërsa në rastin konkret kemi pasur proces të ankimit dhe ky proces në mënyrë automatike sipas ligji është pezulluar, rrjedhimisht Zëvendësuesi i Sekretarit të Përgjithshëm i Ministrisë së Drejtësisë, Vendimin me numër Nr.78/2022 të datës 18.07.2022 e ka nxjerr në kundërshtim me

nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, për arsyet e lartepërmendura, andaj ky vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.4, 1.5 dhe 1.6 të këtij ligji, kështu që anulimi i tij është bërë me qëllim të kthimit të ligjshmërisë sipas nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse Vendimi me numër Nr.78/2022 i datës 18.07.2022 i Zëvendësuesit të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë, nuk i përmban të gjitha elementet e aktit administrativ më konkretisht nuk përmban udhëzimin lidhur me mjetin juridike siç parashihet me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, po ashtu dispozitivi i këtij vendimi si dhe arsyetimi janë kundërthënës mes veti.

Nisur nga të gjitha këto konstatime si më lartë, Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, vlerëson së anulimi i konkursit me nr.reference:RN00008455 për lëvizje brenda kategorisë për pozitën "Udhëheqës i Divizionit për Teknologji Informativ dhe Shërbime Logjistike", është anuluar me shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës si dhe Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, kështu që pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara.

Andaj Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë është i obliguar që në pajtim me dispozitat e nenit 46 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, ku është e përcaktuar se: "**3.KVLBK themelohet nga udhëheqësi më i lartë administrativ i institucionit, me propozim të NJBNJ. Për secilin anëtar, caktohen një anëtar kryesor dhe një anëtar zëvendësues. Anëtari zëvendësues ushtron detyrën në rastin e pamundësisë të përkohshme të anëtarit kryesor. Në rast të pamundësisë së pjesëmarrjes të Mbikëqyrësi i Drejtpërdrejtë, ai zëvendësohet nga një nëpunës tjetër i të njëjtës kategori me të**", ndërlidhur me paragrafin 2 të këtij neni të bëjë themelimin e Komisionit për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë. Ndërsa Njësia e Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë, pas këtij veprimi është e obliguar të ndërmerret të gjitha veprimet juridike që të vazhdojë procedurën respektivisht fazën e procedurës së rekrutimit nga kjo fazë dhe të njëjtin ta përfundojë në pajtim me dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës.

Në rast të moszbatimit të vendimit të Këshillit nga personi përgjegjës i përcaktuar në dispozitiv të këtij vendimi, Kryetari i Këshillit ndërmerr të gjitha veprimet në pajtim me nenin 21, 23 dhe 24 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke aplikuar edhe ndalimin e 50% të pagës mujore për personin përgjegjës, deri në zbatimin e vendimit të Këshillit.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë- Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
Lënda me numër A.nr.696/2022

Zyle Millaku Gojnovci

Procesmbajtëse

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë ;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.

